



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.119/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Hasan Shala dhe Nenad Laziq anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Deçan, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçan, për shkak të vendosjes së posterëve në ndërtesë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohen** si të bazuara ankesat e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Anr.119/2014 dhe Anr.120/2014 të datës 03.06.2014 dega në Deçan, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçan i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 800 (tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 03.06.2014, ka pranuar ankesat Anr.119/2014 dhe Anr.120/2014, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 02.06.2014, subjekti politik AAK, ka vendosur posterët e kandidatëve të tyre për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës në ndërtesë publike.

- Sipas ankesës Anr.119/2014, pretendohet se me datën 02 qershor 2014 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje nga Qendra në Deçan, në ora 12:00 kanë vërejtur se në ndërtesën e PTK-së ishin vendosur posterët e kandidatit Lahi Brahimaj nga subjekti politik AAK. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast subjekti politik AAK ka bërë shkelje të nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi i ka bashkangjitur dy fotografi.
- Sipas ankesës Anr.120/2014, pretendohet se me datën 02 qershor 2014 rreth orës 12:00 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) nga Qendra në Deçan, kanë vërejtur se në ndërtesën e PTK-së janë të vendosura posterët e kandidatit Hajdar Sutaj nga subjekti politik AAK. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast subjekti politik AAK ka bërë shkelje të nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Lidhur me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi i ka bashkangjitur dy fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe 122 paragrafi 1 pika a), subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e informoi dhe Urdhëroi që të ndërmarr masat përmirësuese lidhur me ankesën më datën 04.06.2014, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj anekese deri më datë 05.06.2014 në ora 09:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK në të cilën thekson se vendosja e posterave në ndërtesën PTK-së në Deçan, të kandidatëve për deputet në Kuvendin e Kosovës, Lahi Brahimaj dhe Hajdar Sutaj, nuk është bërë nga struktura subjektit të tyre dhe pretendon se vendosja e posterit mund të jetë bërë nga qytetar apo individ të pidentifikuar. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik AAK konfirmon se në momentin e njoftimit për ankesë ka kontaktuar Shtabin Zgjedhor për Komunën e Deçanit për të bërë heqjen e këtyre posterave të parashtruara në ankesë dhe në cilësinë e provës, përgjigjes ia kanë bashkangjitur Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së drejtuar të gjithë strukturave të AAK-së për respektimin Ligjit mbi zgjedhjet, fotografinë në të cilën dëshkohet veprimi i largimit të posterit të vendosur në ndërtesën e PTK-së në Deçan dhe kërkesën drejtuar shefave të Shtabeve Zgjedhore për respektim të Kodit zgjedhor të datës 30.05.2013.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### **Ankesat janë të bazuara**

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik AAK Lahi Brahimaj dhe Hajdar Sutaj janë të vendosura në ndërtesë publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe

- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik AAK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posterat e kandidatëve për deputet kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e tyre. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterat nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik AAK është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatëve të saj janë të vendosura në ndërtesë publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik AAK që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.119 /2014 më datën 05.06.2014.



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*